VENDIM
Nr. 28, datë 18.5.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[1]

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.5.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 27 (A) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aleks Lici, Lefteria Lici

SUBJEKT I INTERESUAR: Telemah Rajdho, Këshilli i Qarkut Gjirokastër

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 5, 7, 15, 17, 33, 42, 43, 116, 122, 31, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i", 135, 142 dhe 145, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6 dhe 13, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 49, pika 3, shkronja "e", 71 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*),

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesit Aleks Lici dhe Lefteria Lici janë bashkëshortë. Kjo e fundit është motra e shtetasit Telemah Rajdho. Sipas kontratës noteriale të shitjes nr. 2035 rep. dhe nr. 881 kol., datë 9.10.2000, *(kontrata e shitjes së truallit),* kërkuesit dhe subjekti i interesuar kanë blerë nga Këshilli i Qarkut Gjirokastër (seksioni i financës) truallin me sipërfaqe 1380 m^2, të ndodhur në Gjirokastër. Më herët, për këtë truall, Këshilli i Rregullimit të Territorit (*KRRT*) pranë Këshillit të Qarkut Gjirokastër, me vendimin nr. 15, datë 13.4.1993, ka miratuar sheshin e ndërtimit dhe, më pas, me vendimin nr. 14,

[1] *Saktësuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 39, datë 14.7.2023.*
" Saktësimin e pikës 3, të dispozitivit të vendimit nr. 28, datë 18.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese, i cili bëhet si vijon: "3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë".

datë 8.4.1998, ka miratuar dhënien e lejes së ndërtimit për objektin "lokal dhe banesë". Në vijim, me vendimin nr. 1, datë 24.7.2003, KRRT-ja, Gjirokastër ka miratuar sheshin dhe lejen e ndërtimit për objektin "shtesë anësore lokali e banese në të dyja krahët në pronë të vet". Pas ndërtimit të objektit dhe shtesave anësore mes kërkuesve dhe subjektit të interesuar kanë lindur mosmarrëveshje në lidhje me pronësinë e truallit dhe objektit të ndërtuar mbi të, që posedoheshin nga kërkuesit, të cilët pretendonin se ishin pronarë të vetëm të kësaj pasurie.

2. Për sa më sipër, nga viti 2006 e në vijim janë zhvilluar disa procese gjyqësore, prej të cilave kërkuesit, kanë kundërshtuar procesin e katërt gjyqësor, i cili është edhe objekt i këtij gjykimi kushtetues (*shih paragrafët 10–19 të këtij vendimi*). Duke qenë se faktet dhe rrethanat e procesit të kundërshtuar nga kërkuesit lidhen edhe me faktet dhe rrethanat e proceseve të tjera gjyqësore, në vijim të këtij vendimi do të pasqyrohen të gjitha proceset gjyqësore që lidhen me çështjen objekt i këtij gjykimi kushtetues.

a) Procesi i parë civil (*procesi kryesor me objekt njohjen e bashkëpronësisë*)

3. Sipas akteve të dosjes gjyqësore rezulton se subjekti i interesuar ka paraqitur padi në gjykatë kundër kërkuesve, duke kërkuar detyrimin e tyre ta njihnin bashkëpronar mbi pasurinë truall dhe ndërtesë. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 2209, datë 15.12.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka vendosur pranimin e padisë. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur ankim në gjykatën e apelit të dyja palët ndërgjyqëse.

4. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 113, datë 18.3.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2209, datë 15.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër. Ndër të tjera, gjykata e apelit ka arsyetuar se nuk qëndronte pretendimi i kërkuesve për falsitetin dhe pavlefshmërinë e pjesshme të kontratës së shitjes së truallit për sa i përkiste paditësit Telemah Rajdho (për shkak të mosregjistrimit të saj referuar paragrafit të parë të nenit 83 të Kodit Civil), pretendim ky që, sipas saj, as nuk ishte kundërshtuar gjyqësisht sipas rregullave procedurale (si pavlefshmëri relative e pretenduar). Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë bërë rekurs të dyja palët ndërgjyqëse dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-2, datë 14.1.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

b) Procesi i dytë civil *(me objekt njohjen e pavërtetësisë së dokumenteve "Kërkesë për leje ndërtimi" dhe "Leje ndërtimi" (formulari nr. 4)*

5. Ndërsa procesi kryesor ndodhej në gjykatën e apelit, në datën 27.2.2009, kërkuesi Aleks Lici ka paraqitur padi kundër subjektit të interesuar Telemah Rajdho dhe Këshillit të Rrethit Gjirokastër, person i tretë Lefteria Lici, me objekt: *"Njohje e pavërtetësisë së dokumenteve "Kërkesë për leje ndërtimi" dhe "Leje ndërtimi nr. 379 prot., datë 15.5.1998 (formulari nr. 4)."*.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 1017, datë 29.5.2009, ka vendosur pranimin e padisë, ndërsa Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 469, datë 7.12.2009, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi Aleks Lici, për të cilin Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2011-830, datë 9.6.2011, ka vendosur mospranimin e tij.

c) Procesi i tretë civil (*me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes së truallit*)

7. Ndërkohë që procesi kryesor ndodhej në Gjykatën e Lartë, në datën 11.10.2010, kërkuesi Aleks Lici ka vënë në lëvizje një proces tjetër gjyqësor, duke paditur shtetasin Telemah Rajdho dhe Seksionin e Financës në Këshillin e Rrethit Gjirokastër, person i tretë Lefteria Lici, me objekt konstatimin si absolutisht të pavlefshme të kontratës së shitjes së truallit për pjesën që i përkiste të paditurit Telemah Rajdho.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 245, datë 8.3.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se paditësi nuk ka parashtruar para gjykatës konflikt

juridiko-civil të kërkueshëm në rrugë gjyqësore, pasi mungon kërkimi i rregullimit të pasojave juridike të krijuara si rezultat i pavlefshmërisë absolute të pretenduar.

9. Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 313, datë 1.7.2011, ka vendosur pushimin e gjykimit, me arsyetimin se në rastin konkret ndodhej para një padie që nuk mund të ngrihej dhe gjykimi nuk mund të vazhdonte, pasi nuk mund të konstatohej nga gjykata pavlefshmëria e një kontrate, në rrethanat kur me vendim gjyqësor të formës së prerë (vendimi në procesin kryesor, që tashmë kishte përfunduar edhe në Gjykatën e Lartë) ishte pranuar bashkëpronësia e palëve, pra se kontrata e shitjes ishte e bazuar në ligj. Po ashtu, sipas gjykatës së apelit, edhe baza ligjore, sipas nenit 111 të KC-së, nuk qëndronte, pasi veprimi juridik ishte i pandashëm dhe nuk kishte pjesë të tij vetëm për sa i përket të padituri Telemah Rajdho.

ç) Procesi i katërt civil objekt i këtij gjykimi kushtetues (*me objekt njohjen e pavërtetësisë së pjesshme të dokumenteve "kontratë shitje e truallit" dhe "akt vlerësimi datë 29.9.2000", si dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes së truallit*)

10. Në datën 7.1.2012, kërkuesi Aleks Lici ka vënë në lëvizje një proces tjetër gjyqësor, me të paditur Telemah Rajdho, Lefteria Lici dhe Këshilli i Qarkut Gjirokastër, me objekt njohjen e pavërtetësisë së pjesshme për shkak falsiteti të kontratës së shitjes së truallit, si dhe pavërtetësinë e pjesshme të aktit noterial që i ka dhënë formë veprimit juridik, për shkak falsiteti, për pjesën që paraqitet blerës subjekti i interesuar. Gjithashtu, ai ka kërkuar edhe pavërtetësinë e pjesshme të aktit të vlerësimit të datës 29.9.2000, për shkak falsiteti, për pjesën e shkrimit dhe nënshkrimit të subjektit të interesuar (*akti i vlerësimit*), duke kërkuar papërdorshmërinë e këtij dokumenti.

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, me vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe shpalljen si të falsifikuar të kontratës së shitjes së truallit dhe aktit të vlerësimit. Sipas gjykatës së shkallës së parë kërkimi për pavërtetësinë e dokumenteve për shkak të falsitetit të kontratës së shitjes së truallit dhe aktit të vlerësimit, nuk ka qenë më parë objekt shqyrtimi gjyqësor. Për kërkimin për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes së truallit, gjykata ka arsyetuar se ky kërkim ishte i njëjtë me atë të gjykuar më parë me vendim përfundimtar, midis të njëjtave palë dhe për të njëjtin shkak ligjor (vendimi nr. 245, datë 8.3.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, i lënë në fuqi me vendimin nr. 313, datë 1.7.2011, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër), ndaj për këtë shkak ky kërkim duhej të rrëzohej.

12. Mbi bazën e ankimit të bërë nga kërkuesi Aleks Lici dhe i padituri Telemah Rajdho, vendimi nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe vendimi i kësaj të fundit është shfuqizuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka dërguar çështjen për rigjykim.

13. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për të gjitha disponimet e tij, përveç atij për kërkimin për falsitet të aktit të vlerësimit dhe pasojave të këtij falsiteti si më poshtë: rrëzimin e padisë për kërkimin për falsitetin e aktit të vlerësimit dhe për papërdorshmërinë e këtij dokumenti.

14. Në vendimin e saj, lidhur me kërkimin e padisë për pavlefshmërinë absolute të pjesshme të kontratës së shitjes së truallit, gjykata e apelit ka çmuar se nuk ndodhej përpara "gjësë së gjykuar", duke arsyetuar se në gjykimet e mëparshme nuk ishte vënë në diskutim shkaku i pretenduar në këtë gjykim nga kërkuesi për falsitetin e saj, si dhe me vendimin gjyqësor të formës së prerë, vendimin nr. 313, datë 1.7.2011, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështja ishte pushuar me arsyetimin se ishte para një padie që nuk mund të ngrihej, vendim ky që nuk mund të përbëjë "gjë të gjykuar", sa kohë nuk ka vendosur për pranimin ose rrëzimin e padisë. Nga ana tjetër, për këtë kërkim padie, gjykata e apelit e ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e tij, me arsyetimin se gjykata nuk mund të japë vendim për deklarimin si absolutisht të pavlefshëm të një veprimi juridik,

për sa kohë kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesa ose pretendime në lidhje me zgjidhjen e pasojave që vijnë nga pavlefshmëria absolute, referuar për këtë vendimit unifikues nr. 13/2006, të Gjykatës së Lartë.

15. Lidhur me kërkimin për pavërtetësinë e aktit të vlerësimit dhe papërdorshmërinë e tij, gjykata e apelit e ka gjetur të pabazuar këtë kërkim, duke arsyetuar se në konsideratë edhe të orientimit të Gjykatës së Lartë për vlerësimin e këtij dokumenti në raport me kërkesat e nenit 253 të KPC-së, ky dokument përbënte akt zyrtar me fuqi të plotë provuese dhe në këtë këndvështrim nuk rezultonte të kishte falsifikim të tij për sa i përket tërësisë së aktit, ndërsa shkaku i pretenduar nga paditësi (kërkuesi Aleks Lici) nuk lidhej me veprimet e kryera nga nëpunësi shtetëror, të cilat ishin korrekte dhe të bazuara në ligj.

16. Për sa i përket kërkimit të padisë për pavërtetësinë e kontratës së shitjes të truallit dhe papërdorshmërinë e saj, gjykata e apelit ka arsyetuar se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka shpallur tërësisht të falsifikuar këtë kontratë, pasi veprimi juridik i dokumentuar përmes saj është një veprim juridik i pandashëm, në kuptim të nenit 111 të KC-së, sikurse një gjë e tillë ishte pranuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë, vendimin nr. 113, datë 18.3.2009, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

17. Mbi bazën e rekurseve të paraqitura nga kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, ka vendosur të ndryshojë vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, duke rrëzuar kërkesëpadinë për njohjen e pavërtetësisë së pjesshme për shkak falsiteti dhe konstatimin pjesërisht të pavlefshmërisë absolute për shkak të kundërligjshmërisë së kontratës së shitjes së truallit. Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër për pjesën tjetër. Me këtë vendim, praktikisht padia e kërkuesit Aleks Lici është rrëzuar në tërësi.

18. Sipas Gjykatës së Lartë, në rastin konkret, kjo çështje përbën gjë të gjykuar, për rrjedhojë gjykata e shkallës së parë në lidhje me padinë duhej të vendoste pushimin e gjykimit. Gjithashtu, sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit nuk e ka pasur të qartë natyrën e mosmarrëveshjes, pasi nuk ka arritur të identifikojë se cili ka qenë objekti i kërkimit, shkaku i padisë dhe palët në konflikt dhe si rrjedhojë nuk ka identifikuar drejt nëse ndodhej para dy çështjeve të njëjta apo jo, për të vlerësuar nëse ishte para gjësë së gjykuar. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se është e njëjta çështje, me të njëjtat palë, me të njëjtin objekt dhe të njëjtin shkak padie sikurse çështja e mëparshme (procesi kryesor), ku padisë së paditësit Telemah Rajdho i ishte dhënë përgjigje me vendim gjyqësor të formës së prerë, ndaj, ndryshe nga sa arsyeton gjykata e apelit, ky kërkim ka rënë në prekluzivitet për kërkuesit për shkak të parimit të "gjësë së gjykuar". Në lidhje me këtë, Gjykata e Lartë ka referuar atë që e konsideron si praktikë të konsoliduar në lidhje me konceptin *"gjë e gjykuar e heshtur",* për të cilin është shprehur edhe më parë.

19. Në datën 7.7.2022, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në këtë Gjykatë në datën 31.10.2022. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 20.1.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 1.2.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

20. ***Kërkuesit*** në kërkesën drejtuar Gjykatës kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt, në drejtim të:

20.1. *Zbatimit të gabuar të parimit të gjësë së gjykuar,* pasi Gjykata e Lartë ka konsideruar "gjë të gjykuar" një çështje që nuk ka qenë asnjëherë më parë e tillë në vendimet të cilave ajo u referohet. Akti i vlerësimit është bërë objekt padie për herë të parë në procesin e katërt gjyqësor, në çështjen nr. regj. 21/21266-00003-21-2012, dhe nuk është gjykuar ndonjëherë nga vendimet e cituara nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

20.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në përputhje me qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca kushtetuese dhe nga ajo vetë në lidhje me parimin e "gjësë së gjykuar". Ajo nuk ka arsyetuar se përse ka vendosur ta zhvillojë gjykimin në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesve. Vendimi i saj është kontradiktor, pasi për shkak të presjes që është vendosur në fjalinë e fundit nënrenditëse të dispozitivit, kuptohet sikur padia është pranuar pjesërisht, ndërkohë që shprehet ndryshe në paragrafin 33 të vendimit.

20.3. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi nuk është respektuar procedura e caktimit të shortit për përbërjen e trupit gjykues dhe e caktimit të datës së zhvillimit të gjykimit. Procedura e zhvilluar në Gjykatën e Lartë është bërë në rrethana të dyshimta dhe me parregullsi të shumta, që ngrenë dyshime për veprime të paligjshme deri në falsifikim të akteve. Asnjë nga fashikujt nuk shoqërohet me inventar për përmbajtjen e numrit të fletëve dhe nënshkrimin përkatës në inventar. Gjithashtu, gjykatat më të ulëta kanë vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe mbi rekursin e kërkuesve Gjykata e Lartë, duke e konsideruar çështjen gjë të gjykuar, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke dalë kështu jashtë objektit të saj, në kundërshtim edhe me nenet 31 e vijues të KPC-së. Gjykata e Lartë në këtë rast ka dhënë një zgjidhje që asnjë nga palët nuk e ka kërkuar, duke përkeqësuar pozitën e kërkuesve.

20.4. *Së drejtës së mbrojtjes dhe të aksesit*, pasi kërkuesit nuk janë njoftuar për zhvillimin e gjykimit në datën 7.3.2022. Ata nuk janë njoftuar as në adresën elektronike të përfaqësuesit të tyre, edhe pse ai e kishte lënë adresën e tij në rekurs. Gjykata e Lartë duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore dhe të dëgjonte pretendimet e kërkuesve. Ajo i ka cenuar këto të drejta edhe për faktin se ka zbatuar dispozitën kalimtare që i jep të drejtë të revokojë vendimet e mëparshme të saj për shqyrtimin e çështjes në seancë me praninë e palëve. Gjithashtu, ka vendosur në kundërshtim me nenin 484 të KPC-së dhe nuk ka dhënë asnjë shkak për shtyrjen e marrjes së vendimit.

20.5. *Parimit të paanshmërisë*, pasi të njëjtët gjyqtarë që kanë shqyrtuar çështjen objekt të këtij gjykimi kushtetues, kanë pasur në shqyrtim edhe çështjen tjetër të kërkuesve nr. 1111-00027-00-2012 dhe objekt "Rishikimin e vendimeve të procesit të parë gjyqësor". Edhe pse për këtë të fundit (çështjen me objekt rishikimin e vendimeve të procesit të parë gjyqësor) anëtarët e trupit gjykues kanë dhënë dorëheqjen, konstatohet se ajo është dhënë në datën 1.4.2022, pas dhënies së vendimit objekt të këtij ankimi kushtetues. Gjithashtu, konstatohet se megjithëse anëtarët e trupit gjykues kanë dhënë dorëheqjen, ndihmësja ligjore ka mbetur e njëjta.

20.6. *Së drejtës për një proces të drejtë,* pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin e ministrit të Drejtësisë nr. 353, datë 3.9.2013, "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio" (*udhëzimi nr. 353/2013*), pasi nuk e ka regjistruar seancën në çështjen e kërkuesve. Gjithashtu, procesverbali i seancës është i paplotë. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me nenet 1, 4, 7, 11 etj., të KPC-së, pasi e ka shqyrtuar çështjen pa pasur në dispozicion të gjitha aktet që ndodheshin në fashikullin e gjykimit. Gjykata e Lartë ka dhënë një vendim pa u bazuar në prova dhe në ligj, si dhe pa zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm.

21. ***Subjekti i interesuar, Telemah Rajdho***, dhe ***Këshilli i Qarkut Gjirokastër,*** nuk kanë paraqitur prapësime, edhe pse janë njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesve

22. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

23. Gjykata çmon se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ku është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

24. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 56, datë 21.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesit kanë kundërshtuar vendimin nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili ka përmbyllur procesin e katërt gjyqësor në ngarkim të tyre, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se ata i kanë shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendojnë se u janë cenuar.

26. Gjykata çmon se kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit gjyqësor që ka vendosur për çështjen e tyre është i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i datës 7.3.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 7.7.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

27. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke argumentuar, ndër të tjera, se nuk është respektuar procedura e caktimit të shortit për përbërjen e trupit gjykues dhe e caktimit të datës së zhvillimit të gjykimit. Procedura e zhvilluar në Gjykatën e Lartë është bërë në rrethana të dyshimta dhe me parregullsi të shumta, që ngrenë dyshime për veprime të paligjshme deri në falsifikim të akteve. Sipas tyre, asnjë nga fashikujt nuk shoqërohet me inventar për përmbajtjen e numrit të fletëve dhe nënshkrimin përkatës në inventar. Gjithashtu, ata kanë pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë, pasi të njëjtët gjyqtarë që kanë shqyrtuar çështjen objekt të këtij gjykimi kushtetues, kanë pasur në shqyrtim edhe çështjen tjetër të kërkuesve nr. 1111-00027-00-2012 dhe objekt "Rishikimin e vendimeve të procesit të parë gjyqësor". Sipas tyre, edhe pse anëtarët e trupit gjykues kanë dhënë dorëheqjen, konstatohet se ajo është dhënë në datën 1.4.2022, pas dhënies së vendimit objekt të këtij ankimi kushtetues.

28. Për sa më sipër, referuar këtyre pretendimeve të kërkuesve, lidhur me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë caktuar me ligj, Gjykata vëren se, në ndryshim nga sa pretendojnë ata, në aktet bashkëlidhur kërkesës ndodhet edhe praktika e caktimit të relatorit të çështjes, edhe përbërja e trupit gjykues, të nënshkruara nga kancelari i Gjykatës së Lartë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Gjithashtu, rezulton se kërkuesit janë njohur me përbërjen e trupit gjykues në Gjykatën e Lartë dhe nuk kanë paraqitur asnjë pretendim në lidhje me të. Për këtë arsye, këto argumente të kërkuesve janë haptazi të pabazuara.

29. Ndërsa, për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë, Gjykata konstaton se, ashtu siç edhe ka parashtruar kërkuesi, anëtarët e trupit gjykues të Gjykatës së Lartë, pasi kanë dhënë vendimin objekt të këtij gjykimi kushtetues, kanë dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes me objekt rishikimin e vendimeve të procesit të parë gjyqësor. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se vetëm pjesëmarrja e të njëjtëve gjyqtarë në këto çështje nuk mjafton për konstatimin e cenimit të parimit të paanshmërisë, përderisa nuk ka një vendimmarrje ose vlerësim prej tyre për të dyja këto çështje. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesve është haptazi i pabazuar.

30. Për sa i përket pretendimit të kërkuesve për cenimin e së drejtës për një proces të drejtë, për shkak se nuk është zbatuar udhëzimi nr. 353/2013, si dhe janë cenuar nenet 1, 4, 7, 11 etj., të KPC-së, pasi Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen pa pasur në dispozicion të gjitha aktet që ndodheshin në fashikullin e gjykimit, Gjykata rithekson qëndrimin e saj të konsoliduar se interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Gjykata ndërhyn kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesve ka të bëjë, në thelb, me çështje të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, ndërkohë që ata nuk kanë arritur ta ngrenë atë në nivel kushtetues, pra të tregojnë cenimin e ardhur në të drejtat e tyre kushtetuese nga kjo veprimtari.

31. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuesve, Gjykata vëren se ata kanë pretenduar se është zbatuar gabim parimi i gjësë së gjykuar, për shkak se Gjykata e Lartë ka konsideruar "gjë të gjykuar" një çështje që nuk ka qenë asnjëherë më parë e tillë në vendimet të cilave ajo u referohet, si dhe standardi i arsyetimit të vendimit, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në përputhje me qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca kushtetuese dhe nga ajo vetë në lidhje me parimin e "gjësë së gjykuar". Për rrjedhojë, këto pretendime, për nga thelbi dhe natyra e tyre, Gjykata vlerëson që të trajtohen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar. Këto pretendime të kërkuesve, bashkë me pretendimet e tjera të tyre, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga gjë gjykatë e caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke dalë jashtë objektit të saj, së drejtës së aksesit dhe së drejtës së mbrojtjes do të shqyrtohen në vijim nga Gjykata për bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit lidhur me zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar

32. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë ka gabuar në arsyetimin e saj, pasi ka quajtur gjë të gjykuar një çështje e cila nuk ka qenë asnjëherë më parë gjë e gjykuar në vendimet të cilave u referohet ajo gjykatë, si dhe nuk ka arsyetuar në përputhje me qëndrimet e mbajtura nga jurisprudenca kushtetuese dhe nga vetë ajo në lidhje me gjënë e gjykuar. Gjithashtu, ajo nuk ka arsyetuar pse ka vendosur ta zhvillojë gjykimin në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesve. Sipas tyre, , vendimi është kontradiktor, sepse për shkak të presjes që është vendosur në fjalinë e fundit nënrenditëse të dispozitivit, kuptohet sikur është pranuar padia pjesërisht, ndërkohë që paragrafi 33 i vendimit shprehet ndryshe . Ata kanë pretenduar se nuk ndodhen përpara gjësë së gjykuar, pasi akti i vlerësimit është bërë objekt padie për herë të parë në procesin e katërt gjyqësor, në çështjen nr. regj. 21/21266-00003-21-2012, si dhe nuk është gjykuar ndonjëherë në vendimet e cituara nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

33. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimet nr. 11, datë 10.3.2023; nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 6, datë 16.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

34. Në këtë drejtim, vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik *(shih vendimet nr. 11, datë 10.3.2023; nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 19, datë 1.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*.

35. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se, referuar procesit të parë gjyqësor, kontrata e shitjes së truallit ose elemente të saj nuk kanë qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor. Në këtë proces nga kërkuesit është ngritur pretendimi për falsitetin dhe pavlefshmërinë e pjesshme të kontratës së shitjes së truallit, por gjykatat, për arsye procedurale, nuk e kanë marrë në shqyrtim atë, duke mos u shprehur për të dhe për elementet e vlefshmërisë së saj. Në procesin e dytë gjyqësor rezulton se kontrata e shitjes së truallit nuk ka qenë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe palët nuk kanë ngritur pretendime për të. Ndërkohë, referuar procesit të tretë gjyqësor, Gjykata konstaton se kontrata e shitjes së truallit ka qenë objekt gjykimi, por përsëri, për arsye procedurale, nuk është shqyrtuar themeli i çështjes dhe gjykatat nuk janë shprehur në lidhje me elementet e vlefshmërisë së saj. Për sa i takon procesit të katërt gjyqësor, Gjykata evidenton se objekt i këtij procesi ka qenë kontrata e shitjes së truallit dhe akti i vlerësimit. Po ashtu, Gjykata konstaton se akti i vlerësimit nuk ka qenë objekt shqyrtimi në asnjë prej proceseve gjyqësore (procesi i parë, dytë dhe i tretë) të mëparshme të zhvilluara nga të njëjtat palë dhe është bërë objekt gjykimi për herë të parë në procesin e katërt gjyqësor, i cili është edhe objekt i këtij gjykimi kushtetues.

36. Referuar procesit të katërt gjyqësor, rezulton se gjykata e shkallës së parë pretendimin për pavlefshmërinë e kontratës e ka konsideruar gjë të gjykuar, ndërsa gjykata e apelit ka mbajtur qëndrim të kundërt me atë të gjykatës të shkallës së parë. Pas rekursit të paraqitur nga kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e padisë së tyre, duke e quajtur çështjen në tërësi gjë të gjykuar, përfshirë këtu edhe pretendimin për aktin e vlerësimit. Sipas arsyetimit që ka bërë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, kjo çështje është gjykuar më parë, duke iu referuar procesit të tretë gjyqësor, dhe ajo është pushuar për shkak se nuk mund të konstatohej pavlefshmëria e kontratës kur ka një vendim gjyqësor të formës së prerë për njohjen si bashkëpronar, si dhe të gjitha pretendimet e kërkuesve lidhur me kontratën i janë nënshtruar më parë bisedimit dhe kanë marrë zgjidhje me një vendim që ka marrë formë të prerë.

37. Në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar, Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kufijtë e zbatimit të këtij parimi përcaktohen në lidhje të ngushtë me thelbin e mosmarrëveshjes në gjykim. Në këtë aspekt, Gjykata ka çmuar se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata

ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 29, datë 21.12.2006, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për sa më sipër, në kuptim të parimit të gjësë së gjykuar, bazuar në faktet e kësaj çështjeje dhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore që kanë shqyrtuar këtë mosmarrëveshje, Gjykata vëren se nuk rezulton që nga gjykatat t'u jenë dhënë përgjigje përfundimtare elementeve të pavlefshmërisë së kontratës së shitjes së truallit. Në procesin e parë civil gjykatat e zakonshme nuk e kanë marrë në shqyrtim këtë pretendim, pasi, sipas tyre, ai nuk ishte ngritur në formën e kërkuar nga ligji, ndërsa në procesin e tretë civil ato kanë arsyetuar se pavlefshmëria e kontratës së shitjes së truallit nuk mund të konstatohet me vendim gjykate, kur më parë po me vendim gjykate është pranuar bashkëpronësia. Po ashtu, edhe pretendimit tjetër i kërkuesve për pavërtetësinë e pjesshme të aktit të vlerësimit, nuk rezulton t'i jetë dhënë përgjigje më parë nga gjykatat.

39. Për sa më sipër, Gjykata çmon se i takonte Gjykatës së Lartë, në përputhje me rolin e saj *subsidiar*, të bënte një analizë të plotë dhe shteruese të fakteve dhe qëndrimeve të gjykatave të zakonshme përgjatë proceseve gjyqësore mes palëve ndërgjyqëse, për të arritur në një përfundim të drejtë në lidhje me ekzistencën ose jo të gjësë së gjykuar në rastin konkret, qoftë për kontratën e shitjes së truallit, qoftë për aktin e vlerësimit. Pavarësisht se Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka vlerësuar se kërkimi i kërkuesve për kontratën e shitjes së truallit ka rënë në prekluzivitet, pasi në rastin konkret ndodhemi para "gjësë së gjykuar të heshtur", ajo për të arritur në këtë përfundim i është referuar procesit të parë civil (procesi kryesor me objekt njohjen e bashkëpronësisë), por nuk ka arritur të arsyetojë në drejtim të fakteve të vërtetuara dhe së drejtës së zbatuar që u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj.

40. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e gjësë së gjykuar është i bazuar dhe duhet pranuar.

41. Në kushtet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar duhet shfuqizuar, pasi është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, dhe çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon të mos shprehet për pretendimet e tjera të kërkuesve, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit dhe së drejtës së mbrojtjes.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa është e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.5.2023.
Shpallur më 19.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Sandër Beci, Genti Ibrahimi

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen nr. 27 (A) 2022, me kërkues Aleks Lici dhe Lefteria Lici, i bashkohemi shumicës në lidhje me zgjidhjen e kësaj çështjeje, për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë. Megjithatë, në vlerësimin tonë, Gjykata nuk duhej ta trajtonte çështjen në drejtim të pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të lidhur me parimin e gjësë së gjykuar, por në drejtim të pretendimit të kërkuesve për tejkalimin e kufijve të shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, çka përbënte bazë të mjaftueshme për ta bërë të cenueshëm atë vendim pa u ndalur në bazueshmërinë e pretendimeve të tjera të parashtruara në këtë kërkesë.

2. Kërkuesit kanë pretenduar se edhe pse gjykatat më të ulëta kanë vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, Gjykata e Lartë, e vënë në lëvizje mbi rekursin e tyre, duke e konsideruar çështjen gjë të gjykuar, ka vendosur rrëzimin tërësisht të kërkesëpadisë, duke kapërcyer kështu kufijtë e shkaqeve të parashtruara në rekurs. Sipas tyre, Gjykata e Lartë ka dhënë një zgjidhje që asnjë nga palët nuk e ka kërkuar, duke përkeqësuar pozitën e kërkuesve mbi rekursin e tyre (*shih paragrafin 20.3. të vendimit*). Në lidhje me këtë pretendim, shumica, duke e trajtuar në këndvështrim të standardit të gjykatës së caktuar me ligj, ka arsyetuar se "*në kushtet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar duhet shfuqizuar, pasi është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, dhe çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon të mos shprehet për pretendimet e tjera të kërkuesve, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, së drejtës së aksesit dhe së drejtës së mbrojtjes*" (*shih paragrafin 41 të vendimit*).

3. Për rrjedhojë, Gjykata e ka lënë pa përgjigje këtë pretendim të kërkuesve, edhe pse në vlerësim tonë shqyrtimi i tij ishte i nevojshëm, pasi do e çonte atë në një qëndrim të drejtë në lidhje me këtë çështje. Kjo, sepse në rast se Gjykata do e gjente të drejtë këtë pretendim, pra nëse do arrinte në përfundimin se Gjykata e Lartë ka dalë tej shkaqeve të aktit mbi të cilin është vënë në lëvizje, do të ishte i panevojshëm çdo vlerësim i mëtejshëm i pretendimeve të kërkuesve, pasi kjo do ta detyronte atë gjykatë të rigjykonte çështjen duke u shprehur edhe një herë në lidhje me bazueshmërinë e shkaqeve të parashtruara në rekurs. Vetëm nëse do e vlerësonte të pabazuar këtë pretendim, Gjykata do të mund të vijonte më tej me vlerësimin e pretendimeve të tjera, pra edhe të atij për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar. Mosdhënia përgjigje këtij pretendimi, në situatën që çështja është kthyer për rishqyrtim në Kolegjin Civil, mund të çojë sërish në cenimin e të drejtave të kërkuesve në drejtim të kufijve të shqyrtimit të saj.

4. Për më tepër, në vlerësimin tonë, ky pretendim i kërkuesit është i bazuar edhe në themel, pasi edhe pse është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paditësit Aleks Lici (e paditura Lefteria Lici ka paraqitur rekurs për të njëjtat shkaqe dhe kërkime), Gjykata e Lartë ka vendosur në përfundim rrëzimin praktikisht të padisë në tërësinë e saj, duke cenuar edhe atë pjesë të vendimeve gjyqësore që ka vendosur në favor të palës rekursuese. Kërkuesi nuk ka përcaktuar standardin kushtetues ku e ka bazuar këtë pretendim, por është shprehur se vendimi i Gjykatës së Lartë ka përkeqësuar pozitën e

palës rekursuese, ndërkohë që shumica e ka përfshirë atë në standardin e gjykatës së caktuar me ligj, në drejtim të mënyrës se si Gjykata e Lartë ka ushtruar kompetencat e saj.

5. Në jurisprudencën kushtetuese parimi i mosrëndimit të pozitës së palës që vë në lëvizje gjykatën me ankim, i njohur si *reformatio in peius,* është parë vetëm në këndvështrim të garantimit të të drejtave të të pandehurit në procesin penal. Ky rregull është i parashikuar në mënyrë të shprehur në Kodin e Procedurës Penale dhe e ndalon gjykatën që të caktojë një dënim më të rëndë nga ai i caktuar me vendimin e kundërshtuar kur apelues është vetëm i pandehuri. Gjykata ka vlerësuar se megjithëse Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues dhe është konsideruar si një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës më të lartë, e cila merr rëndësi në një shoqëri demokratike dhe për këtë arsye askush nuk mund ta humbasë këtë përparësi. Ekzistenca e këtij parimi i jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta, vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre. Parë nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit *reformatio in peius* përbën njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së (*shih vendimin 13, datë 15.4.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në ndryshim nga legjislacioni penal, KPC-ja nuk ka parashikuar në mënyrë të shprehur një parim i tillë të zbatueshëm në procesin civil, ashtu siç ndodh me legjislacione të vendeve të tjera. Megjithatë, garantimi i të drejtave të palëve që vënë në lëvizje gjykatën me ankim realizohet përmes kufizimit që dispozitat procedurale i kanë vënë juridiksionit gjyqësor për të mos dalë tej shkaqeve dhe kërkimeve të palëve. Më konkretisht, sipas nenit 465, pika 1, të KPC-së, gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda kufijve të ankimit. Në lidhje me shqyrtimin e rekursit, sipas nenit 473/a të KPC-së, Gjykata e Lartë e shqyrton rekursin brenda kufijve të tij, përveç se kur ligji parashikon ndryshe.

7. Parimi i ndalimit të përkeqësimit të situatës së palëve nëpërmjet paraqitjes së mjetit të ankimit, pavarësisht se jo i shprehur në mënyrë eksplicite, gjen zbatim edhe në fushën civile për të njëjtat arsye si në atë penale. Ky parim përfaqëson një përbërës thelbësor të së drejtës së mbrojtjes, sepse rreziku i përkeqësimit të situatës juridike të palës që vë në lëvizje gjykatën më të lartë, do të vendoste në një disbalancë ose do të shuante çdo qëllim të palës së interesuar për t'i nënshtruar kontrollit gjyqësor më të lartë vendimin që e konsideron të paligjshëm ose të pabazuar.

8. Ndalimi i veprimit të parimit *reformatio in peius* në të drejtën civile gjen zbatim në drejtim të shqyrtimit të ankimit të vendimeve gjyqësore dhe ai nënkupton që pushteti i gjyqtarit që shqyrton ankimin/rekursin përcaktohet në mënyrë ekskluzive nga palët që e paraqesin atë, me pasojën që në mungesë të ankimit nga njëra palë, vendimi i gjykatës më të lartë nuk mund të jetë më pak i favorshëm për palën që ka bërë ankim se sa ka qenë vendimi i kundërshtuar prej saj, pra të jetë në dëm të kësaj të fundit. Në këtë kuptim, pala që vendos të paraqesë ankim nuk mund të gjendet në një pozitë më pak të favorshme sesa do të kishte qenë po të mos e kishte ushtruar mjetin procedural, kurse mungesa e ankimit nga pala që ka fituar pjesërisht gjykimin prodhon një efekt ndalues/pengues për gjykatën më të lartë, që edhe pse nuk është "gjë e gjykuar", në kuptim të pasojave, mbart pengesën që vendimi i kundërshtuar të ndryshohet në favor të asaj pale dhe në dëm të palës gjyqfituese pjesërisht, e cila është ajo që ka investuar gjykatën.

9. Pavarësisht parimit të kontrollit gjyqësor hierarkik brenda sistemit gjyqësor, që lejon ndryshimin e vendimit të gjykatës më të ulët nga ajo më e lartë, pra që rregullon marrëdhëniet mes gjykatave të shkallëve të ndryshme të gjykimit, dispozitat procedurale që përcaktojnë kufijtë e shqyrtimit të ankimit janë përcaktuese edhe të kufirit të gjyqtarit që e shqyrton atë (ankimin), duke përcaktuar, gjithashtu, ndalimin që ai të vendosë për çështjen me efekt përkeqësues, i cili gjen zbatim

në çdo fazë gjykimi (apel dhe Gjykatë e Lartë). Pavarësisht këtij ndalimi, gjyqtari që shqyrton ankimin edhe duke lënë në fuqi vendimin e kundërshtuar, mundet që kryesisht të korrigjojë ose të ndryshojë arsyetimin e gjykatës më të ulët, për sa kohë që kjo nuk prek disponimin e asaj gjykate të pa kundërshtuar nga palët. Për sa më sipër, pushteti i gjyqtarit përcaktohet në mënyrë ekskluzive nga iniciativa e palëve në proces me pasojën që, siç është theksuar edhe më sipër, në mungesë të ankimit të palës që ka fituar gjyqin pjesërisht, vendimi i gjykatës nuk mund të jetë i disfavorshëm ndaj palës që e ka vënë atë në lëvizje me ankim në krahasim me atë çfarë ka vendosur vendimi i kundërshtuar.

10. Një qëndrim i kundërt do të binte ndesh jo vetëm me të drejtën e mbrojtjes në procesin civil, por edhe me parimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërive të ligjshme, të cilat qëndrojnë në themel të këtij ndalimi procedural, pasi palën që ka vënë në lëvizje gjykatën me ankim kundër vendimit që ka sjellë pasoja negative për të do e ekspozonte ndaj rrezikut që ky veprim (ushtrimi i së drejtës së ankimit) ta vendoste në një pozitë më pak të favorshme se sa do të kishte qenë nëse nuk do e kishte ushtruar atë.

11. Duke iu kthyer rrethanave të kësaj çështjeje, rezulton se kërkuesit nga viti 2006 e në vijim kanë zhvilluar disa procese gjyqësore (*shih paragrafët 3-17 të vendimit*). Procesi gjyqësor objekt i këtij gjykimi kushtetues ka të bëjë me kërkesëpadinë e datës 7.1.2012, të paraqitur nga kërkuesi Aleks Lici, me të paditur Telemah Rajdhon, Lefteria Licin dhe Këshillin e Qarkut Gjirokastër, me objekt njohjen e pavërtetësisë së pjesshme për shkak të falsitetit të kontratës së shitjes së truallit, si dhe pavërtetësinë e pjesshme të aktit noterial që i ka dhënë formë veprimit juridik, për shkak falsiteti, për pjesën që paraqitet blerës subjekti i interesuar, si dhe pavërtetësinë e pjesshme të aktit të vlerësimit të datës 29.9.2000, për shkak falsiteti, për pjesën e shkrimit dhe nënshkrimit të subjektit të interesuar, duke kërkuar papërdorshmërinë e këtij dokumenti.

12. Gjykata e Rrethit Gjirokastër, me vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe shpalljen të falsifikuar të kontratës së shitjes së truallit dhe aktit të vlerësimit. Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për të gjitha disponimet e tij, përveç disponimit për kërkimin për falsitet të aktit të vlerësimit dhe papërdorshmërinë e tij, duke vendosur rrëzimin e padisë për këtë kërkim.

13. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs paditësi (kërkuesi) Aleks Lici, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe atij të apelit dhe pranimin e padisë për të gjitha kërkimet e saj. Rezulton, gjithashtu, se edhe e paditura (kërkuesja) Lefteria Lici ka paraqitur rekurs, ku ka kërkuar ndryshimin e vendimeve dhe pranimin e plotë të kërkesëpadisë, duke parashtruar të njëjtat shkaqe me ato të rekursit të palës paditëse. Ndërkohë që i padituri tjetër në proces, Telemah Rajdho, nuk ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Pavarësisht këtij fakti, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, ka vendosur të ndryshojë vendimin nr. 21-2012-1976/978, datë 5.11.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër dhe vendimin nr. 20-2017-701/378, datë 15.9.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, duke rrëzuar praktikisht në tërësi kërkesëpadinë e paraqitur nga kërkuesi Aleks Lici.

14. Për sa është arsyetuar më sipër në këtë mendim paralel, në kushtet kur kërkuesi është pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me rekurs (si pala gjyqhumbëse pjesërisht), ndërkohë që i padituri Telemah Rajdho nuk ka paraqitur rekurs, kurse e paditura Lefteria Lici u është përmbajtur shkaqeve dhe pretendimeve të rekursit të kërkuesit, Gjykata e Lartë nuk mund të dispononte në këtë mënyrë, pra tej kërkimeve të rekursit, duke cenuar pozitën e kërkuesit dhe duke e vendosur atë në një situatë më të disfavorshme se sa situata që do të kishte qenë nëse nuk do e kishte kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit. Për më tepër, që në rastin konkret nuk duket që jemi para atyre lloj çështjesh të ligjit që merren në shqyrtim kryesisht nga Gjykata e Lartë, pra tej kërkimeve të palëve që e kanë investuar atë, gjë e cila as është vënë në diskutim dhe arsyetuar prej saj.

15. Kjo mënyrë e veprimit të Gjykatës së Lartë vë në dyshim jo vetëm themelin e procesit civil në drejtim të respektimit të standardeve që kërkon e drejta për një proces të drejtë në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, por mbart edhe pasojën e krijimit të një situate pasigurie juridike për palët që investojnë gjykatën më të lartë me ankim. Për të gjitha këto argumente ishte e rëndësishme që shumica të merrte në shqyrtim këtë pretendim dhe të trajtonte në mënyrë të qartë dhe shteruese mënyrën se si zbatohet parimi i ndalimit të përkeqësimit të situatës juridike të palëve në procesin civil (*reformatio in peius*), i lidhur edhe me kufijtë e gjyqtarit të ankimit sipas parashikimeve të dispozitave procedurale civile.

Anëtarë: Marjana Semini, Ilir Toska